

VENDIM
Nr. 760, datë 19.12.2018

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIMIN “GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE TË DISA SIPËRFAQEVE, TRUALL FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM “SHA RIPARIM ARTILERIE”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të pronës nr. 98, me emërtimin “Grup Depo (ish-Reperti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të disa sipërfaqeve, truall funksional dhe objekte, të pronës nr. 109, me emërtim “sh.a. Riparim Artilerie”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas të dhënave të përcaktuara në vendimin nr. 605, datë 17.10.2018, të Këshillit të Ministrave, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e mjediseve për zhvillimin e arsimit e të formimit profesional dhe ofrimin e kujdesit shoqëror nga fondacioni “Fundjavë Ndryshe”.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i jepen fondacionit “Fundjavë Ndryshe” në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

3. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjeksi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe fondacionit “Fundjavë Ndryshe” u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi